Kronikë

Tepelenë, do shisnin 30 kg kanabis dhe një kallashnikov, 4 të arrestuar! Në pranga babë e bir që transportonin thasët me kanabis në makinë (EMRAT)

Operacioni i koduar "Monitorimi" u mor në aksin rrugor "Bënçë-Tepelenë" ku po lëviznin babë e bir

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
15 Nëntor, 09:14 | **Përditësimi: 15 Nëntor, 09:24**

Share

Tepelenë- Babë e bir,banues në fshatin Bënçë të Tepelenës u arrestuan pasi në makinën me të cilën po lëviznin u gjetën 3 thasë me kanabis.

Operacioni i koduar "Monitorimi" u mor në aksin rrugor "Bënçë-Tepelenë" ku babë e bir po lëviznin me makinë.

"në automjetin me drejtues shtetasin Ilir Dura dhe pasagjer shtetasin Franci Dura në urën e Bënçës, Tepelenë, u gjetën 3 thasë me rreth 30 kilogramë cannabis sativa, informoi sot policia

LEXO EDHE:
Gjirokastër/ Trafiku i drogës dhe klandestinëve drejt Greqisë, 'Crossborder' godet grupin me 11 persona! 4 të arrestuar, 5 në kërkim dhe 2 nën hetim (VIDEO)

Gjithashtu, u kap dhe Mehemet Mino, 27 vjeç, që lëvizte me automjetin tip "BMW", i cili monitoronte rrugën ku kalonte automjeti me lëndën narkotike, me qëllim shmangien e shërbimeve të Policisë.

Në vijim të operacionit, shërbimet e Forcës së Posaçme Operacionale kanë kapur dhe arrestuar edhe shtetasin Reshat Bakia, 27 vjeç, pasi qarkullonte pas automjetit me lëndë narkotike, me automjet tjetër ku mbante një armë zjarri kallashnikov dhe municion luftarak, me qëllim shitjen.

Të arrestuar

Ilir Dura, 54 vjeç babai
Franci Dura, 19 vjeç i biri
Mehmet Mino, 27 vjeç
Reshat Bakia, 27 vjeç

Finalizohet nga Drejtoria për Hetimin e Narkotikëve në Departamentin e Policisë Kriminale, në bashkëpunim me Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, operacioni i koduar "Monitorimi", për goditjen e një rasti të shitjes së lëndëve narkotike.

Operacioni, i kryer mbi bazën e inteligjencës policore të siguruar nga Drejtoria për Hetimin e Narkotikëve në DPPSH.

Sekuestrohen 3 thasë me lëndë narkotike cannabis sativa (gjithsej 30 kilogramë), 1 armë zjarri, 3 automjete, 4 celularë dhe një shumë parash.

Arrestohen në flagrancë 4 shtetas (2 shtetasit që transportonin me automjet, lëndën narkotike, një shtetas që monitoronte rrugën ku do kalonte automjeti me lëndë narkotike dhe një shtetas tjetër që kishte në automjet një armë zjarri kallashnikov për ta shitur bashkë me lëndën narkotike).

Si rezultat i administrimit të shpejtë të informacioneve të siguruara nga inteligjenca policore në kuadër të operacionit policor të koduar "Monitorimi", në aksin rrugor "Bënçë-Tepelenë", u kapën në flagrancë dhe u vunë në pranga shtetasit Ilir Dura, 54 vjeç dhe Franci Dura, 19 vjeç (babë e bir), banues në fshatin Bënçë, pasi në automjetin me drejtues shtetasin Ilir Dura dhe pasagjer shtetasin Franci Dura, në urën e Bënçës, Tepelenë, u gjetën 3 thasë me rreth 30 kilogramë cannabis sativa.

Gjithashtu, u kap shtetasi Mehemet Mino, 27 vjeç, që lëvizte me automjetin tip "BMë", i cili monitoronte rrugën ku kalonte automjeti me lëndën narkotike, me qëllim shmangjen e shërbimeve të Policisë.

Në vijim të operacionit, shërbimet e Forcës së Posaçme Operacionale kanë kapur dhe arrestuar edhe shtetasin Reshat Bakia, 27 vjeç, pasi qarkullonte pas automjetit me lëndë narkotike, me automjet tjetër ku mbante një armë zjarri kallashnikov dhe municion luftarak, me qëllim shitjen.

Veprimet procedurale janë kryer nga specialistët për Hetimin e Narkotikëve të DVP Gjirokastër. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, për veprime të mëtejshme.

lajmi ne perditesim...

S.G/Shqiptarja.com

TAG: tepelenë kanabis Gjirokaster franci dura Ilir Dura Mehmet Mino Reshat Bakia

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:

14 Nëntor, 19:00

Ndryshohen drejtorët e policisë në qarqe, do ketë më shumë rend e siguri?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

Arrestimi i policit Albano Rustemi, burime: Merrte shuma të mëdha parash për dekonspirimin e operacioneve! Organizator i shpërndarjes së kanabisit

Sokol Dema

12 Nëntor, 13:45

Ora, veshjet e diploma, ekspozohen sendet personale të Musine Kokalarit! Bibika rrëfen amanetin e disidentes

Piro Nase

12 Nëntor, 12:47

Lezhë/ Lëviznin me kanabis në makinë, arrestohet 19 vjeçari, 3 në hetim (EMRI)

11 Nëntor, 16:09

Gjirokastër/ Zhvati 42 mijë euro nëpërmjet mashtrimit, 'Porosia' prangos 27-vjeçarin! Katër muaj hetime, i gjendet dhe armë

9 Nëntor, 12:45

Aksident i rëndë në aksin Gjirokastër-Tepelenë, një 60-vjeçare përplaset për vdekje nga një automjet! Grupi hetimor në vendngjarje

Piro Nase

8 Nëntor, 20:35

Anglí/ U kap në fermë kanabisi me vlerë 140 mijë paund, dënohet me burg 23-vjeçari shqiptar

7 Nëntor, 16:02

Gjirokastër/ I lidhën në mënyrë të paligjshme sahatin e energjisë një biznesi, procedohen penalisht 2 punonjësit e OSHEE-së!

7 Nëntor, 14:12

Aksident në Levan-Tepelenë, automjeti del nga rruga! Plagoset punonjësi i policisë

6 Nëntor, 10:49

Gjirokastër/ I shpallur në kërkim për vjedhjen e një makine në një lavazh në Memaliaj, arrestohet 45 vjeçari

5 Nëntor, 13:01

Gjirokastër/ Makina e Policisë përplaset me një automjet tjetër! Plagoset Shefi i Policisë Kufitare të Kakavijës dhe shoferi tjetër

2 Nëntor, 13:02



Gjirokastër/ Nxori armën e shërbimit gjatë vizitës mjekësore, pezullohet nga puna Polici (EMRI)

1 Nëntor, 18:30

'Takimet muzikore të dy botëve', mbahet në Gjirokastër edicioni i 15-të i festivalit të muzikës klasike

Piro Nase

31 Tetor, 18:15

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje